



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____/_____/2016

DREJTUAR:

ZOTIT ILIR META

Kryetar i Kuvendit

KËRKUES:

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe më shumë se 1/4 e anëtarëve të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

OBJEKTI:

- 1- Dërgohet për shqyrtim dhe miratim një projektvendim i Kuvendit – Relacioni shoqëruar
- 2- Kërkesë për mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

BAZA LIGJORE:

Neni 88, pika 6 e nenit 13 dhe pika 2 e nenit 32 të Rregullores së Kuvendit.

Z. Kryetar i Kuvendit,

Kapja e pushtetit publik nga krimi nëpërmjet përfshirjes së individëve me rekorde të rënda kriminale nga partitë politike në kandidaturat dhe zgjedhjen e tyre në Kuvend apo pushtetin vendor, si dhe nëpërmjet emerimit në funksione të larta apo funksione kyçe të administratës publike dhe organeve ligjzbatuese, përbën një kërcënim të rëndë për integritetin dhe funksionimin e demokracisë dhe institucioneve demokratike. Në demokraci duhet garantuar që personat që konsiderohen nga shumica e votuesve si të papërshtatshëm për të vendosur për interesat e tyre të qendrojnë jashtë vendimmarrjeve legjislative apo Qeverisë. Qëllimi i këtyre kufizimeve ka për synim mbrojtjen e funksionimit demokratik të institucioneve nga ndikimi i personave me rekorde të rënda penale apo që konsiderohen që mund të ndikojnë negativisht, mbi bazën e dyshimeve të arsyshme. Është interes i lartë publik që politikbërja dhe vendimmarrja të imunizohen nga ky ndikim.

Me ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, janë miratuar rregullat bazë për mbrojtjen dhe garantimin e mirëfunksionimit demokratik të Kuvendit, organeve të qeverisjes vendore, institucioneve kushtetuese apo të krijuara me ligj, administratës publike, Forcave të Armatosura, organeve të rendit publik, sigurisë kombëtare dhe çdo institucioni apo entiteti tjetër ekonomik shtetëror, nga ndikimi apo pjesëmarrja në politikëbërje dhe/ose vendimmarrje i personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve. Miratimi i këtij ligji ishte padyshim suksesi më i rëndësishëm i

Kuvendit të Shqipërisë gjatë vitit 2015 dhe reforma kyce e përkrahur gjerësisht nga partnerët ndërkombëtar. Tashmë Shqipëria duhet të ndërmarrë hapa konkret për zbatimin e këtij ligji dhe pastrimin e organeve publike nga ndikimi i personave me rekorde kriminale.

Në mbështetje të paragrafit 2 të nenit 5, nenit 6 dhe paragrafit 5 të nenit 7 të ligjit nr. 138/2015, Kuvendi me vendim duhet të detajojë: (1) procedurat për realizimin e verifikimit dhe për marrjen e masave për zbatimin e ndalimeve sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; (2) rregullat dhe afatet për plotësimin, dorëzimin, administrimin dhe publikimin e vetëdeklarimeve; (3) përmbajtjen, efektet dhe modelin e formularit të vetëdeklarimit; si dhe (4) përmbajtjen e kërkesës së një partie politike dhe modelin e formularit, për verifikimin paraprak për kandidatura të mundshëm të saj në zgjedhje apo organe kushtetuese apo të krijuara me ligj.

Grupi Parlamentar duke vlerësuar të rëndësishme zbatimin sa më parë të ligjit nr. 138/2015, ka hartuar projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të cilin e gjeni bashkëlidhur, për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Shqipërisë në seancën plenare të datës 25/02/2016, pas diskutimit me prioritet në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, dhe konsensusit të grupimeve parlamentare mbi të.

Projektvendimi ka për qëllim garantimin e zbatimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, nëpërmjet përcaktimit të rregullave të detajuara për të siguruar mbrojtjen dhe garantimin e mirëfunksionimit demokratik të organeve shtetërore, nga ndikimi apo pjesëmarrja në politikëbërje dhe/ose vendimmarrje i personave që janë subjekt i ndalimeve sipas ligjit.

Projektvendimi është i strukturuar në VII Pjesë dhe trajton përgjithshësisht çështje që lidhen me:

- a) Parimet që udhëheqin procesin e vlerësimit;
- b) Rregullat e detajuara dhe afatet për plotësimin, dorëzimin, administrimin dhe publikimin e vetëdeklarimeve. Në këtë rast, projektvendimi specifikon në detaje edhe organet përgjegjëse për administrimin dhe trajtimin fillestar të vetëdeklarimeve.
- c) Përmbajtjen, efektet dhe modelin e Formularit të Vetëdeklarimit. Në këtë rast, pjesë përbërëse e vendimit do të jetë edhe modeli i Formularit të Vetëdeklarimit, i cili është hartuar sipas modelit që ndjek për verifikim Byroja Kombëtare e Hetimit në SHBA.
- d) Kërkesën për verifikim paraprak nga një parti politike për kandidatura të mundshëm të saj në zgjedhje apo organe kushtetuese apo të krijuara me ligj.
- e) Procedurat e hollësishme për realizimin e verifikimit, sipas tre fazave:
 - Verifikim paraprak formal i organit përgjegjës për administrimin e Formularit të Vetëdeklarimit;

- Verifikimi i përmbajtjes së Formularit të Verifikimit nga organi përgjegjës për administrimit;
 - Verifikimi i thelluar nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme.
- f) Procedurat e posacme të vetëdeklarimit nga funksionarët aktual publikë, dhe rregullat e posacme të verifikimit të tyre.
- g) Rregullat kalimtare që garantojnë zbatimin pa vonesë të ligjit nr. 138/2015.

Projektvendimi duhet të shërbejë si bazë për të hapur diskutimin intensiv, konstruktiv dhe konsensual brenda Kuvendit, me qëllimin e miratimit të tij pa asnjë vonesë të mëtejshme. Sipas vendimmarrjes në Konferencën e Kryetarëve, projektvendimi do të shqyrtohet në Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me prezencën edhe të Kryetarit dhe Nënkryetarit të Komisionit të Posacëm Parlamentar që kishte përgjegjësinë për hartimin e ligjit nr. 138/2015. Në këto kushte, bazuar në pikën 6 të nenit 13 të Rregullores së Kuvendit, ku specifikohet se: *“Këshilli mbledhet në mënyrën e parashikuar nga kjo Rregullore për komisionet e përhershme”*; si dhe në pikën 2 të nenit 32 të Rregullores ku përcaktohet se: *“Mbledhjet e komisionit të përhershëm thirren nga kryetari i tij. Ato mund të thirren edhe me kërkesën e jo më pak se një të katërës së anëtarëve të komisionit...”*, Grupi Parlamentar i Partisë Demoraktike dhe ne më shumë se ¼ e anëtarëve të Këshillit,

KËRKOJMË:

1. Thirrjen ditën e martë, datë 23.02.2016 të mbledhjes së Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, në orarin e përshtatshëm që do të vlerësohet nga ana juaj.
2. Mbledhja e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin të ketë në rend dite: Shqyrtimin dhe propozimin për miratim në seancën e ardhshme plenare të projektvendimit *“Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*.

Me bindjen se miratimi i këtij vendimi përbën prioritet edhe për Kuvendin e Shqipërisë,

KRYETARI I GRUPIT PARLAMENTAR TË PARTISË DEMOKRATIKE

EDI PALOKA

ANËTARËT E KËSHILLIT PËR RREGULLOREN, MANDATET DHE IMUNITETIN:

ARBEN RISTANI

GENT STRAZIMIRI

KASTRIOT ISLAMI